

Sulm ndaj një xhamie në Pakistan

Krijuar: Premte, 13 Shkurt 2015 15:15

Sipas informacioneve paraprake thuhet se nga ngjarja të paktën 19 persona kanë humbur jetën, ndërkohë që burime nga ushtria thonë se përplasja e armatosur vazhdon

ISLAMABAD(AA) - Në veri të Pakistanit, në kryqytetin e zonës Hayber-Pakthunkva, Peshaver ndërkohë që në xhami falej namazi i xhumasë nga një sulm me bomba të paktën 19 persona humbën jetën dhe 40 të tjerë u plagosën.

Ushtria pakistaneze përfshet me atentatorët në ambientet e xhamisë, raporton Anadolu Agency (AA).

Sipas zëdhënësit të policisë së Peshaverit ngjarja ka ndodhur në lagjen Hajatbad, ku militantët kanë sulmuar një xhami Shiite dhe se nga informacionet e para nga sulmi të paktën 19 persona kanë humbur jetën dhe 40 të tjerë janë

plagosur.

Grupi i armatosur pas sulmit vazhdoi qëndrimin në xhami, ndërkohë në një kohë shumë të shkurtër shumë forca të sigurisë janë drejtuar drejt vendngjarjes. Ndërkohë theksohet se përleshja e armatosur vazhdon thuhet se personat e

armatosur kanë hyrë në xhami me uniforma policore.